



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 11, DATË 29.01.2020

PËR
KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË SË AUTORIZIMIT TË
SUBJEKTIT PERSON FIZIK DORJAN PERE, PËR PËRSËRITJEN E
SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR
NË RRJET KABLLOR "TV KABLLOR ZARGOÇAN"

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

- Kërkues: Subjekti person fizik Dorjan Pere.
Objekt: Konstatimi i pavlefshmërisë së autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Dorjan Pere, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor "Tv kabllor Zargoçan".
Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 68 pika "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 13 i rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017,

VËREN

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 115, datë 28.03.2011, ka autorizuar subjektin person fizik Gëzim Cake, për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv kabllor Zargoçan" me zonë ofrimi shërbimi "Fshatin Zargoçan". AMA, me vendimin nr. 67, datë 10.05.2017 ka vendosur zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në "Fshatrat Udenisht, Memlisht, Piskupat, Lin (pjesë e njësisë administrative Udenisht), Fshatrat Tushemisht dhe Gurras (pjesë e njësisë administrative Buçimas)" dhe me vendimin nr. 55, datë 19.03.2018, ka azhurnuar zonën e ofrimit të shërbimit të subjektit në "Njësitë Administrative Udenisht dhe Buçimas".

AMA, mbi kërkesën e subjektit, me vendimin nr. 167, datë 07.11.2019, ka vendosur kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve "Tv kabllor Zargoçan", tek subjekti person fizik Dorjan Pere.

Subjekti person fizik Dorjan Pere, me shkresën administruar në AMA me nr. 159 prot., datë 20.01.2020, ka njoftuar për mbylljen e veprimtarisë së subjektit.

Konkretisht subjekti ka parashtruar se: "... kërkoj mbylljen e autorizmit të lëshuar prej datës 01.01.2020 dhe në vazhdim"

Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 68 të tij, parashikon se autorizimi bëhet i pavlefshëm: "b) i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit" dhe rregullorja "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, neni 13, pika 1, përcakton se aplikuesi i cili kërkon të heqë dorë nga autorizimi duhet të paraqesë pranë AMA: "a) Kërkesë me shkrim për heqje dorë nga autorizimi..."

Nga verifikimi i kryer nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, rezulton se subjekti ka ndërprerë transmetimet kabllore. Nga verifikimi i kryer nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, rezulton se subjekti nuk ka detyrime financiare të pashlyera ndaj AMA-s.

Sa më sipër, kërkesa e subjektit është e mbështetur në ligj,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 68, pika "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 13, të rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Dorjan Pere, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv kabllor Zargoçan".
2. Subjekti me njoftimin e këtij vendimi, ka detyrimin të ndërpresë menjëherë transmetimin.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 01.01.2020.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZA

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA